

26.02.2019



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



BASHKËSIA KATOLIKE  
SALLAGRAZHD

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MATERIAL XOREZIM PRIMLJENO RECEIVED	Numri / Broj Number	Shtoja / Prilog Appendix	Vlera / Vrednost Value
Nr. 01	016	14484	2



KOMUNA E SUHAREKËS  
OPSTINE SUVA REKA

Duke u bazuar në nenin 58, të Ligjit Nr-03/L-040, mbi Vetëqeverisje Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008" Kryetari i Komunës me Priftin e Bashkësisë Katolike në fshatin Sallagrazhd, lidhën këtë:

### MARRËVESHJE TË MIRËKUPTIMIT PËR FINANCIM

E hartuar me datën 26.02.2019, e lidhur në mes të palëve:

1. Komunës së Suharekës-përfaqësuar nga Bali MUHARREMAJ-Kryetar i Komunës në Suharekë dhe
2. Priftit të Bashkësisë Katolike në fshatin Sallagrazhd të Komunës së Suharekës-përfaqësuar nga Prifti Don Mikel SOPI.

#### Neni 1

##### Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshje të mirëkuptimit është financimi me mjete financiare për mbulimin e shërbimeve "Kryerja e riteve fetare dhe mbulimi i shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Komunës së Suharekës, përkatësisë fetare Katolike".

#### Neni 2

##### Obligimet e Bashkësisë Katolike

2.1 Këto shërbime do tu ofrohen të gjithë qytetarëve të Komunës së Suharekës, duke respektuar bindjen dhe orientimin fetar (Katolik) të secilit qytetar të Komunës së Suharekës pa dallim.

2.2 Në bazë të kësaj marrëveshje, Këshilli i Bashkësisë Katolike në Sallagrazhd, obligohet që tij kryej shërbimet e riteve fetare dhe varrimit siç janë të përcaktuar në mënyrë decidive në tabelën si më poshtë;

Nr.	Lloji i Shërbimit	Vlera financiare
1.	Transporti i kufomës brenda territorit të Komunës së Suharekës (bartja e kufomës nga shtëpia deri te varrezat)	
2.	Hapja dhe mbyllja e varrit (sipas traditave fetare Katolike). Transporti i punëtorëve dhe mjeteve te punës deri ne varreza dhe anasjelltas.	



3.	Dërrasat (pa arkivol) me te cilat mbulohet kufoma pas lëshimit ne varr me dimensione 2.10 x 1.10 x 0.5 dhe transporti i dërrasave deri te vendi i varrimit.	
4.	Kryqi (si pas traditave fetare katolike)	
5.	Dezinfektimi i veturës dhe flet lajmërimet 30 copa	

### Neni 3

3.1 Shuma e pagesës apo faturës për shërbimet apo ritualet fetare të cekura në nen 2, të kësaj marrëveshje të mirëkuptimit për financim është **200€** (dyqind euro) për 1, (një) person.

3.2 Të gjitha këto shërbime apo rituale fetare do të përmblidhen dhe pëershruhen në një faktuar që Këshilli i Bashkësisë Katolike në Sallagrazhd, do të ja dorëzoj Komunës së Suharekës për pagesë.

3.3 Këshilli i Bashkësisë Katolike në Sallagrazhd, përgatit faturë të veçanet për secilin rast veç e veç, duke ja bashkangjitur edhe këto dokumente përcjellëse; raporti për secilin rast veç e veç, certifikate e vdekjes të të vdekurit, kopja e letërnjoftimit të të vdekurit si dhe kopja e letërnjoftimit të familjarit i cili e ka paraqitur rastin.

### Neni 4

#### Obligimet e Komunës

4.1 **Komuna e Suharekës**, merr për obligim që të bëjë zotimin e mjeteve dhe pagesat, pas dorëzimit të faturës dhe raportit me shkrim nga Këshilli i Bashkësisë Katolike në Sallagrazhd dhe të vërtetuar nga organi mbikëqyrës që caktohet nga Komuna e Suharekës, për punën/shërbimet/furnizimet e kryera, mjetet lëshohen në xhirollogarinë e **Këshillit të Bashkësisë Katolike në fshatin Sallagrazhd**.

4.2 Pagesat e shërbimeve apo shpenzimeve të cekuar në nen 2, të kësaj marrëveshje të mirëkuptimit për financim bëhen në fillim të çdo muajt nga datë 01 deri me datë 05 të muajt vijues.

4.3 Komuna merr për obligim të caktoj organin mbikëqyrës/menaxherin e projektit.

### Neni 5

5.1 Shërbimet e cekuar në nen 2 të kësaj marrëveshje të mirëkuptimit për financim janë pjesë e kësaj marrëveshje dhe në asnje mënyrë nuk ndërlidhen me pagesën e anëtarisë ndaj Bashkësisë Katolike në Sallagrazhd (çështje e cila mbetet edhe me tutje në raportet e deritanishme të qytetarëve me Bashkësinë Katolike).

5.2 Shërbimet shtesë që kërkojen nga familjaret e të vdekurit, e të cilat shërbime nuk janë të paraparë në këtë marrëveshje të mirëkuptimit për financim i barten individualisht familjarit të të vdekurit

### Neni 6

#### Raportimi me shkrim

Projekt menaxheri, organin mbikëqyrës i caktuar nga Komuna e Suharekës në bashkëpunim me Përfaqësuesin e Bashkësisë Katolike në fshatin Sallagrazhd, marrin për obligim që për çdo 3, (tre) muaj të përgatitin **raport me shkrim**, për Komunën e Suharekës, duke i



15.03.2017  
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

justifikuar me kontrata të ndryshëm, faktuara dhe dëftesa, përkatësisht kuponë në pajtueshmëri me Rregulloren financiar Nr-01/2013, MF-shpenzimi i parave publike.

### Neni 7

#### Ndryshimi i marrëveshjes me mirëkuptim

Me pëlqimin paraprak të Këshillit të Bashkësisë Katolike në Sallagrazhd dhe Komunës së Suharekës, kjo marrëveshje mundë të ndryshohet dhe plotësohet me aneks marrëveshje.

### Neni 8

Marrëveshja e mirëkuptimit për financim është e lidhur me aftë kohor të caktuar dhe atë duke filluar nga 01.03.2019 deri me datën 01.03.2020, afat 1, (një) vjeçar.

### Neni 9

#### Shkëputja e marrëveshjes

Marrëveshja e mirëkuptimit për financim mund të shkëpute njëanshëm nga Komuna e Suharekës me njoftimin paraprak me shkrim në aftë prej 30 ditësh në rast se Këshilli i Bashkësisë Katolike në Sallagrazhd, nuk e përbushë këtë marrëveshje të mirëkuptimit për financim në përpikëri ashtu si që është nënshkruar nga palët nënshkruuese.

### Neni 10

#### Zgjidhja e marrëveshjes

Të gjitha palët zotohen se do t'i përbahen kësaj marrëveshje të mirëkuptimit për financim dhe se në rast kontesti eventual apo paqartësitë në tekstin e kësaj marrëveshje, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim, në të kundërtën kompetent për të vendos do të jetë Gjykata Themelore në Prizren dega në Suharekë.

### Neni 11

#### Numri i kopjeve

Kjo marrëveshje e mirëkuptimit për financim është e hartuar në 3, ekzemplarë identik ku nga një e marrin palët, kurse të tjerat mbresin për nevojat e organit kompetent.

### Neni 12

#### Hyrja në fuqi

Palët në marrëveshje janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptimit për financim të fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

### P A L Ë T N Ë M A R R Ë V E S H J E

Prifti i Bashkësisë Katolike

Mikel SOPI

28.02.2019

B. S. P.



Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ

